



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 14.3.2011, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Sevdije Lama, Hetem Arifi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Konstituimi i Komisionit**
- 2. Të ndryshme**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për të vetmin pikë të **rendit të ditës**, çështje të cilat i numëroi shkurtimisht dhe për të cilat nuk kishte vërejtje.

Nait Hasani përshëndeti anëtarët e komisionit duke ju dëshiruar punë të mbarë në këtë legjislacion dhe i njoftoi se kjo mbledhje është caktuar me qëllim të njoftimit paraprak me disa çështje si dhe anëtarët të njihen mes vedit. Rendi i ditës nuk është caktuar pasi që është mbledhje konstituive, mirëpo ai sugjeroi që komisioni të harmonizoi mendimet për disa çështje dhe të njoftohet si vijon :

- **Mbajtja e mbledhjeve të këtij komisioni në të ardhmen**
Komisioni u pajtua që të mbahen mbledhjet e komisionit të haneve në orën 11,00.
- **Plani i punës së Komisionit**
Komisioni konstatoi se plani i punës do të diskutohet në takimin dy ditor që do të mbahet më vonë, por paraprakisht të kontaktohen përfaqësuesit e dy ministrive më 21 mars kur do të diskutohet buxheti i vitit 2011.
- **Takimi dy ditor i komisionit me mbështetjen e OSCE**
Lidhur me këtë takim komisioni mori informata nga përfaqësuesi i OSCE **Lumni Rama** (i cili tha se e zëvendëson **Blerim Velën**) i cili njoftoi komisionin që kjo organizatë do të mbështesë komisionin sa i përket fushës së mjedisit më tepër,

ndërkaq takimi dyditor propozohet nga OSCE për të miratuar komisioni planin e punës dhe mbështetja do të jetë ashtu siç parasheh komisioni agjendën pa ndonjë imponim, në Prishtinë apo jashtë Prishtinës. Para se të mbahet takimi, stafi do të njoftoi më detalisht lidhur me agjendën, ngase Kuvendi paraprakisht ka planifikuar njëherë mbajtjen e trajnimit me deputet të rinjë, përfundoi ai. **Liburn Aliu** ngriti çështjen e kësaj organizate e cila ka qëndrim neutral ndaj Kosovës, mirëpo **kryetari** theksoi se kjo mbështetje ka të bëjë vetëm me ngritjen e kapaciteteve në komision sa i përket mjedisit dhe bujqësisë dhe jo me çështje politike, ngase të gjitha çështjet politike shqyrtohen në seancat plenare të Kuvendit.

- **Mbledhja e Kryetarit të Kuvendit me Kryetarët e Komisioneve më 14 mars 2011**
Në këtë mbledhje z. Krasniqi kërkoi nga kryetarët që të caktohen mbledhjet e komisioneve ku do të shqyrtohet **buxheti i vitit 2011** sipas projektit të dërguar nga Qeveria, secili komision në fushën e vet. Nëse ka propozime ato do të prezantohen deri më 24 mars kur do të mbahet seanca plenare për miratimin e buxhetit përfundimtar për këtë vit. Gjithashtu në këtë mbledhje kryetari z. Krasniqi kërkoi angazhim maksimal nga komisionet sa i përket miratimit të projektligjeve në Kuvend duke njoftuar edhe për fondin e komisionit prej 10.000 euro i cili fond do të mund të shfrytëzohet për punën sa më të mbarë lidhur me daljet në terren dhe angazhim të ekspertëve përkatës. Nëse do të ketë nevojë për asistent, komisioni mund të angazhoi sipas nevojës me ndihmën e fondit që ka, përfundoi kryetari, ndërkaq **Nijazi Idrizi** insistoi në ndihmën me ekspert e jo me asistentë.

Pas përfundimit të takimit kryetari caktoi mbledhjen për dt. 21.3.2011 në orën 11,00 me rendin e ditës ku do të shqyrtohet buxheti i vitit 2011 duke ftuar edhe përfaqësuesit e dy ministrave (ministrat), ndërsa në pikën Të ndryshme kryetari do të njoftoi Komisionin me ofrimin e ndihmës me ekspert nga NDI-ja.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,45.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani